


Tregtia e jashtme e mallrave

Nëntor 2018

Tiranë, më 17 Dhjetor 2018: Në Nëntor 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u rritur me 6,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe ulur me 9,9 %, në krahasim me Tetor 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 56 mld lekë, duke u rritur me 2,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe ulur me 3,9 %, në krahasim me Tetor 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 29 mld lekë, duke u ulur me 1,5 %, krahasuar me Nëntor 2017 dhe rritur me 2,5 %, në krahasim me Tetor 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 289 mld lekë, duke u rritur me 15,0 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 581 mld lekë, duke u rritur me 2,8 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 292 mld lekë, duke u ulur me 7,0 %, krahasuar me 2017.

Për publikim 17/10/2018

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 6,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +2,9 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me +2,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,4 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2018




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori janë rritur me 15,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritje vjetore e importeve prej 2,3 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +3,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Ushqime, pije, duhan” me -2,0 pikë përqindje, etj.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2018



Si njëmbëdhjetëmujor, importet janë rritur me 2,8%, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,6 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me +0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Ushqime, pije, duhan” me -0,02 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Nëntor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2017 janë: Kosova (34,9 %), Spanja (63,9 %) dhe Gjermania (22,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-2,3 %), Kina (-21,5 %), dhe SHBA (-14,4 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (3,2 %), Kosova (28,2 %) dhe Spanja (66,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kina (-34,3 %), Ukraina (-47,1 %) dhe Rusia (-24,1 %).

Në muajin Nëntor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Nëntor 2017 janë: Turqia (1,6 %), Kina (3,3 %) dhe Gjermania (5,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-7,4 %), Rusia (-64,6 %) dhe Zvicra (-27,8 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (4,4 %), Greqia (3,6 %) dhe Kina (9,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-1,1 %), Gjermania (-2,8 %) dhe Zvicra (-27,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 64,6 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,9 %), Kina dhe Gjermania (6,8 %), dhe Turqia (6,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin 2018, me vendet e BE zënë 66,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Nëntor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,4 %), Greqia (6,8 %), Gjermania (6,6 %) dhe Kina (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-28	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-30	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-28	42,8
	10 - 16	22	7,3	50	-0,8	-28	43,5
	11 - 16	23	17,5	50	1,0	-27	46,2
	Janar - Nëntor16	222	-1,6	523	6,5	-302	42,3
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,5	58	15,5	-33	43,1
	11 - 17	25	11,1	55	10,4	-29	46,5
	Janar - Nëntor17	251	13,2	565	8,0	-314	44,4
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,7	-27	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	11 - 18	27	6,7	56	2,3	-29	48,5
	Janar - Nëntor18	289	15,0	581	2,8	-292	49,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Nëntor 17	Nëntor 18	Jan. -Nën. 2017	Jan. - Nën . 2018	Nëntor 17	Nëntor 18	Jan. - Nën . 2017	Jan. -Nën . 2018
Vendet e BE-së	19.893	20.807	193.355	220.512	32.952	32.861	348.040	356.404
Austri	194	225	1.524	1.714	458	552	6.073	6.117
Mbretëri e Bashkuar	43	72	388	1.081	617	461	4.982	5.314
Gjermani	961	1.176	10.016	12.510	4.242	4.486	46.341	45.022
Greqi	944	1.100	10.722	12.246	3.536	3.815	45.358	47.000
Itali	13.856	13.532	134.323	138.687	15.808	14.638	162.356	160.535
Spanjë	1.120	1.835	13.619	22.665	1.051	1.344	12.355	15.156
Kroaci	94	67	785	824	372	580	4.076	6.161
Të tjera të BE-së	2.682	2.800	21.977	30.785	6.868	6.984	66.499	71.100
Kinë	739	580	8.028	5.277	4.932	5.097	44.226	48.192
Kosovë	1.859	2.507	19.442	24.930	755	710	7.696	8.085
Maqedonia	617	711	7.784	7.950	813	832	7.993	8.737
Rusi	0	28	82	62	1.383	490	10.891	11.719
SHBA	552	473	2.920	4.785	463	542	7.814	8.165
Turqi	199	142	1.991	2.025	4.746	4.820	46.496	48.519
Ukrainë	34	37	452	239	176	404	2.919	2.887
Zvicër	77	49	1.047	2.887	1.325	956	11.396	8.234
Të tjera	1.435	1.781	15.900	20.051	7.119	9.221	77.906	80.190
Gjithsej	25.406	27.114	251.001	288.720	54.663	55.933	565.377	581.134

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Eksporte			
	Nëntor 17	Nëntor 18	Jan. - Nën. 2017	Jan. - Nën . 2018	Nëntor17	Nëntor 18	Jan. - Nën . 2017	Jan. - Nën . 2018
Gjithsej	25.406	27.114	251.001	288.72	54.663	55.933	565.377	581.134
Ushqime, pije, duhan	3.484	3.468	27.519	29.734	8.969	7.868	97.018	96.899
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	3.768	3.669	39.923	53.250	5.604	7.389	57.396	60.592
Produkte kimike dhe plastike	438	562	4.409	5.730	7.133	6.815	79.130	79.611
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	223	179	2.699	2.528	1.798	1.614	17.313	17.407
Prodhime druri dhe letre	866	1.440	7.470	8.899	2.217	2.142	21.768	23.098
Tekstile dhe këpucë	10.250	10.988	108.071	114.826	8.325	8.074	79.406	80.684
Materiale ndërtimi dhe metale	4.047	4.500	40.112	49.582	6.519	6.279	71.026	71.220
Makinëri, pajisje dhe pj, këmb.	1.633	1.600	13.886	16.610	11.305	13.437	119.675	128.629
Të tjera	697	708	6.913	7.561	2.794	2.315	22.643	22.994

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	134.323	138.687	19.442	24.930	13.619	22.665	10.016	12.510
Ushqim. pije duhan	7.659	7.469	2.540	2.558	761	1.166	1.313	1.366
Minerale. lëndë djegëse. ener. elek.	7.323	4.348	4.744	6.126	10.054	17.943	919	1.833
Produkte kimike dhe plastike	1.274	1.509	1.130	1.210	14	54	21	36
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.032	1.843	7	9	84	243	14	11
Prodhime druri dhe letre	5.298	6.409	392	443	6	287	96	149
Tekstile dhe këpucë	84.279	88.461	114	107	2.419	2.786	5.305	6.374
Materiale ndërtimi dhe metale	14.858	16.048	8.754	12.474	270	145	934	874
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	8.413	9.092	669	771	2	32	1.086	1.319
Të tjera	3.187	3.510	1.092	1.232	9	10	328	549

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Turqi		Greqi		Kinë	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	162.356	160.535	46.496	48.519	45.358	47.000	44.226	48.192
Ushqim. pije duhan	16.504	16.113	5.108	5.121	12.578	13.775	623	601
Minerale. lëndë djegëse. ener. elek.	15.096	10.704	1.570	690	6.753	7.203	8	7
Produkte kimike dhe plastike	17.099	17.138	6.592	7.433	7.209	7.012	4.380	4.608
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	13.453	13.529	328	286	75	51	680	698
Prodhime druri dhe letre	6.089	6.779	3.161	3.092	2.997	3.156	950	1.029
Tekstile dhe këpucë	39.419	39.172	14.762	15.425	3.601	3.412	10.203	9.778
Materiale ndërtimi dhe metale	18.147	19.230	5.791	7.127	8.331	8.028	5.695	6.321
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	31.073	32.512	7.077	7.097	2.187	2.716	16.583	20.239
Të tjera	5.475	5.358	2.105	2.247	1.628	1.649	5.104	4.911

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri